



VENDIM

Nr. 108 Datë 01.10.2013

**PËR
MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “JUANA” SH.P.K NGA HEC
“ORENJE” ME NR. 14, SERIA PV04P, LËSHUAR ME VENDIM TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 05, DT. 12.03.2004**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike, si dhe nenet 10 dhe 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.10.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “JUANA” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr. 14, Seria PV04P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 05, datë 12.03.2004 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “JUANA” sh.p.k plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

• **Neni 15, pika 4, germa “a”:**

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës. (është plotësuar tërësisht)

• **Neni 15, pika 4, germa “b”:**

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit te cilat shprehin vullnetin për te kërkuar modifikim liçense. (është plotësuar tërësisht)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë liçensën e shoqërisë “Juana”sh.p.k me numër Nr. 14, Seri PV04P, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec “Orenje” me fuqi 75 KW, lëshuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 05, dt. 12.03.2004.
2. Fuqia e instaluar e Hec “Orenje”, nga 75 KW të bëhet 875 KW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari në detyrë
Shkëlqim Bozgo**